" YLBERI " SH.P.K.

PERMBLEDHJA JOTEKNIKE

PER SHFRYTEZIMIN E KROMIT

Objekti "Galerite 9, 17, venburimi Theken", Qarku DIBER

KORRIK 2025

P E R M B A J T J A

a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;
f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;
i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.
k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

a) qëllimin e projektit të propozuar;

Projekti i propozuar ka per qellim shfrytezimin e mineralit te kromit ne Lejen Minerare nr.507/1 dt.04.08.1999 ne objektin "galeria nr.9 dhe 17", Theken-Martanesh, Bashkia Bulqize, Qarku Diber me nje siperfaqe prej 0.035 km2 leshua nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë

Shoqeria "YLBERI" sh.p.k. eshte pajisur me leje minerare Nr. 507/1 date 04.08.1999 per shfrytezimin e mineralit te kromit ne duçkat e vjetra si dhe ne çeliqet e ketij minerali te mbetura nga shfrytezimi nentokesor i meparshem ne objektin, galerite nr 9,17 te vendburimit te Theknes, Bulqize, Qarku Diber. Gjate periudhes se zoterimit te lejes shfrytezimit kjo shoqeri ka investuar per zhvillimin e ketij aktiviteti ne rruge, makineri e paisje, ndertesa etj, duke rritur nga viti ne vit grafiket e prodhimit dhe investimet. Shoqeria drejtohet nga nje staf i specializuar dhe me pervoje te gjate ne pune. Ne perberje te ketij stafi bejne pjese; inxhinier miniere(Drejtues teknik), teknike miniere,gjeolog, mekanik, elektricist, ekonomist, zjarrmetar me shume pervoje.
Ne vemendje te shoqerise ka qene zbatimi i kerkesave te Ligjit Minerar te Shqiperise dhe akteve nenligjore te tij si ne drejtim te zhvillimit dhe administrimit te ketij aktiviteti dhe kerkesave ne rritje per zbatimin e projektit te shfrytezimit , kerkesa teknike dhe zbatimit te rregulloreve te sigurimit teknik ne pune.
Objekti eshte shfrytezuar nga ish miniera e kromit Bater me ane te galerive nr. 9,17, ku eshte zbatuar sistemi me galeri nenkati i aplikuar masivisht ne minieren Bater, Bulqize dhe miniera te tjera te kromit, sistem i cili eshte i njohur per humbjen dhe varferimin e mineralit nga 13-15% deri ne 30% e me shume.

Zona ne te cilen ndodhet objekti eshte ne Qarkun e Dibres, Bashkia Bulqize rreth 13km larg qytetit te Krastese Lidhet me rruge automobilistike me Tiranen dhe Elbasanin dhe minieren e kromit Maja e lugut, Kraste, Lugu i Thelle, Ternove dhe Bater. Zona perreth eshte e mbuluar me pyje pishe dhe ahu. Fshati me i afert eshte Lena.

Territori ku ndodhet leja është kryesisht me reliev malor-kodrinor. Objekti ben pjese ne harten topografike te shkalles 1 : 25 000, me nomenklature K-34-89-D-a (Ternova) ka nje siperfaqe prej 0.035 km^2 dhe kufizohet nga keto koordinata :

KORDINATAT (Gauss)			
PIKAT	Y	X	Z
1	4440590	4587680	1476-1512
2	4440595	4587547	1476-1512

3	4440646	4587503	1476-1512
4	4440692	4587503	1476-1512
5	4440700	4587550	1476-1512
6	4440700	4587680	1476-1491-1512
7	4440700	4587735	1476-1491
8	4440707	4587735	1476-1491
9	4440716	4587808	1476-1491
10	4440715.1	4587939.8	1476-1491
11	4440715	4587956	1476-1491
12	4440736	4587967	1476-1491
13	4440743	4588027	1476-1491
14	4440778	4588027	1476-1491
15	4440778	4588072	1476-1491
16	4440695	4588099	1476-1491
17	4440658	4588074	1476-1491
18	4440626	4588038	1476-1491
19	4440720	4588025	1476-1491
20	4440704	4587952	1476-1491
21	4440660	4587680	1476-1491-1512

KORDINATAT (KRGJSH)			
PIKAT	X	Y	Z
1	524058.3	4587343.7	1476-1512
2	524064.9	4587210.8	1476-1512
3	524116.4	4587167.4	1476-1512
4	524162.3	4587167.9	1476-1512
5	524169.8	4587215	1476-1512
6	524168	4587372.5	1476-1491-1512
7	524167.7	4587400	1476-1491
8	524174.7	4587400.1	1476-1491
9	524182.8	4587473.2	1476-1491
10	524180.4	4587604.9	1476-1491
11	524180.1	4587621.1	1476-1491
12	524201	4587632.4	1476-1491
13	524207.3	4587692.4	1476-1491
14	524242.3	4587692.9	1476-1491
15	524241.8	4587737.8	1476-1491
16	524158.5	4587763.9	1476-1491
17	524121.8	4587738.5	1476-1491

18	524090.2	4587702.1	1476-1491
19	524184.3	4587690.2	1476-1491
20	524169.2	4587617	1476-1491
21	524128.3	4587344.5	1476-1491-1512

Siperfaqja e Lejes minerare eshte 0.035 km2



c) **informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;**

Zona ne te cilen ndodhet objekti eshte ne Qarkun e Dibres, Bashkia Bulqize rreth 13km larg qytetit te Krastese Lidhet me rruge automobilistike me Tiranen dhe Elbasanin dhe minieren e kromit Maja e lugut, Kraste, Lugu i Thelle, Ternove dhe Bater. Zona perreth eshte e mbuluar me pyje pishe dhe ahu. Fshati me i afert eshte Lena.
Ne veri-perendim te objektit rreth 10 mk ne vije ajrore ndodhet qyteti I Bulqizes, ne jug-perendim rreth 5 km ndodhet Fshati Lene dhe ne lindje te objektit rreth 6.5 km ndodhet fshati Ternove e Madhe.
Relievi eshte kryesisht kodrinor, malor, ne pjese ku do te punohet , lartesite levizin nga 1400m—1800 m. Malet me te larte jane mali i Dhoksit me lartesi 2020 m. i cili ndodhet ne jug-lindje te qytetit te Bulqizes. Zona e lejuar per shfrytezim ndodhet ne perendim te vendburimit te Theknes, mbi rrugen Theken-Ballenje Objekti eshte hapur nga galerite nr.7a,14,29,30,31 dhe 32 , midis kuotave +1465 dhe +1672.
Ne afersi te objektit nuk ka burime te ujit te pishem te cilat mund te demtohen nga shfrytezimi i minaralit te kromit ne kete objekt.
Ne zone, ekonomia nuk eshte e zhvilluar, pasi edhe vite me pare kane funksionuar vetem sektore te shfrytezimit pyjor te cilet tani e kane nderprere aktivitetin e tyre. Banore e kesaj zone kryesisht merren me bujqesi e blegtori, tregeti, shfrytezimin e mineralit te kromit, etj.. .

Popullsia

Popullsia eshte e punesuar kryesisht ne miniere,. Fushe tjeter punesimi per banoret e zones eshte shfrytezimi pyjor, perpunimi i drurit, ndertimi,me pak tregetia, sherbimet komunale, eti. Zona e Bulqizes dhe Krastes si gjithe zonat e tjera Veri-Lindore te vendit vleresohen si zona te varfera, me nivel te ulet ekonomik. Pozicioni jo i favorshem, largesia nga qendrat e medha urbane, infrastruktura rrugore e dobet,kushtet klimaterike te veshtira,etj kane cuar ne nje levizje te madhe te popullsise drejt zones qendroreTirane-Durres, ku mund te sigurohet nje jetese me e mire.
Ekonomia e zones dhe aktivitet kryesore.
Popullata merret me bujqesi, blegtori, pemtari dhe me minierat.
Kemi te bejme me nje zone te varfer, infrastruktura ne anen shqiptare len per te deshiruar.

QARKU I DIBRES

Organizimi administrativ



ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;




PLANIMETRIA E PUNINEVE
Shkalla 1 : 1000
4440 600
4440 700
100
000
900
800
700
600
500


PROFILI XVII
Shkalla 1 : 500
S 262, 48, 286, 51
S 47, 467
S 317, 28
NK II
NK I
GAL. 5
NK II
NK I
GAL. 2
NK I
GAL. 17
NK II
NK I
GAL. 9
1550
1520
1490
1470
X = 45 87 600
X = 45 87 660
KONTURI I LEJES

PROFILI XIII
Shkalla 1 : 500




PROFILI XV
Shkalla 1 : 500
S 43, 42
S 253,475,310
S 443, 316, 281
S 358,471
1580
1550
1520
1490
1470
Nivell G 8
G 17
NK II
NK I
GAL 9
Konturi i lejes
X = 45 87 700
X = 45 87 650
X = 45 87 600

PROJEKSIONI VERTIKAL I TRUPIT



d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

Per sa i perket ndertimit te objekteve siperfaqesore, eshte vendosur nje kontenier me funksion zyra dhe ambjente te tjera si garderob, magazine materialesh etj.. .

Llojet, Stratigrafia dhe mosha e shkëmbinjve qe marrin pjese ne ndërtimin e rajonit dhe vendburimit.
Zona ku është kërkuar leja minerare e shfrytëzimit, ndodhet në vedburimin kromitik Theken, në shtratimin magmatik harcburgitik (të tektoniteve), ambjent gjeologjik ky, produktiv, përsa i përket ndodhjes në të, të fushave kromitike, të permasave të konsiderueshme dhe cilësisht të pasura. Ajo ka ndërtim gjeologjik përgjithësisht të thjeshtë..

Llojet shkëmbore, që marrin pjesë në ndërtimin gjeologjik të kësaj zone.
*Peridotitet (harcburgitet);*ashtu si në të gjithë masivin ultrabazik të Bulqizës, janë llojet shkëmbore më të përhapur edhe në këtë zonë. Kjo dhe për faktin se, siç e kemi thënë dhe më lart, zona në fjalë, vendoset në shtratimin magmatik të tektoniteve. Mbizotërijnë harcburgitet mesatarisht të serpentinizuara me 15-65 % serpentinë. Më pak takohen peridotitet pak të serpentinizuara me 5-15 % serpentinë, ndërsa harcburgitet e freskëta takohen në thellësi të mëdha të prerjes magmatike. Harcburgitet zënë rreth 55-60 % të masës shkëmbore në tërësi

Dunitet; jane llojet shkëmbore, të dytët përsa i takon përhapjes në masivin shkëmbor dhe kryesisht i përkasin nivelit të breznimeve harcburgit-dunit. Pra ata i përkasin nivelit të thellë në prerjen magmatike. Zënë rreth 20-25 % të masës shkëmbore në tërësi. Vendosen në ambjentin e peridotiteve (harcburgitik), në formë masivësh të vegjël e thjerrzash,xhepash e folesh dhe zgjaten, në përputhje me shtrirjen e struktures së masivit në tërësi, VP-JL, me azimut shtrirje 310-3400. Dallohen dy fusha:
Fusha dunitike veriore ku lokalizohet objekti Thekna Veriore.Fusha dunitike jugore ku lokalizohet objekti kryesore Thekna.
Në dunitet e vendosura në shtratimin harcburgitik, shpesh hjerë, por jo domosdoshmërisht, lidhet prania e mineralizimeve kromifere, duke shëbyer shtrat dhe si "këmishe dunitike".
Serpentinitet; janë lloje shkëmbore, të formuar si rezultat i ndryshimit të formacioneve shkëmbore parësore, siç janë peridotitet dhe dunitet, prej proceseve dytesorë, si rezultat i veprimit të hidrotermave të ftohta (ujrave). Seria damarore; përfaqësohet nga formimet parësore magmatike dhe formimet dytësore.
-Formimet parësore magmatike përfaqësohen kryesisht nga damarë të piroksenitеve dhe me rrallë të duniteve,serpentiniteve,mikrogabrat,,amfiboliti si dhe depozitimet sedimentare.Trupat xeherore jane mbeshtjelle nga nje kemishe dunitike.
-Fomimet dytësore përfaqësohen nga formime damarore karbonatike të aragonitit, kalcitit dhe më rrallë të magnezitit. Janë produkt i proceseve hidrotermale të ftohta (ujrave). Vendosen në sistemin e çarjeve parësore, linjave apo zonave të fuqishme tektonike, si material mbushës i tyre. Kanë ngjyre hiri, të bardhe në të qumësht, deri në krem, ndërtim kristalin, në rastin e kalcitit me kristale të formuara shumë mirë, thyerje guackore. Zënë rreth 3-5 % të mases shkëmbore në tërësi.

Brekçjet ultrabazike, përfaqësojnë një mbulesë materialesh (shkëmbinjsh terrigjene) me përbërje ultrabazike. Për nga pikpamja granulometrike janë material copëzor i trashë me blloqe, copra e çakëll, të çimentuara nga material i imët.
Formimet kuaternare, zënë sektorë të veçantë në zonë si në Dhoks, luginën e Përroit të Duriçit, gryka përrenjsh dhe funde shpatesh, etj.

Objekti i kromit ndodhet ne zonen afer qendrore te fushes minerare Theken ne Martanesh dhe shtrihet ne drejtim te pjeses perndimore te ketij v.burimi. Ne ndertimin gjeoligjik te kesaj pjese te objektit marrin pjese kryesisht shkembinjte peridotite te llojit Harcburgit dhe olivina që eshte e llojit Forsterit
Dunitet jane me te kufizuara se peridotitet.. Ato takohen ne mes te peridotiteve ne forme daljesh me pamje te ndryshme me gjatesi 1-2 ml deri ne disa qindra metra dhe me gjersi te dukshme nga 2.0ml deri ne 250 ml. Daljet siperfaqsore te tyre jane ne forme thjerrzash, shliresh me pamje damarore e thjerrzore. Kontakti mes ketyre llojeve shkembote ne pergjithesi eshte gradual por shpesh takohen dhe kontakte tektonike , sidomos ne pjesen lindore teV.burimit te Theknes.
Serpentinitet takohen me rrale ne V.burim. Ato paraqiten krytesiht prane zonave tektonike dhe kane pamje te brezave dhe linjave me permasa te vogla ne trashesi dhe shtrirje deri ne disa metra.
Mikrogabrot takohen kryeshit ne pjesen veriore te V.burimit te Theknes dhe perfaqsojne pjesen me apikale te V.Burimit dhe prerjes magmatike. Nuk gjenden ne objektin tone.
Dallohet tektonika shkeputese ne pergjithesi dhe ne lindje te vendburimit Bulqize-Bater ne vecanti,

Forma dhe elementet e shtrirejes se trupave xeherore
Trupat xeherore ne vendeburimin e theknes kane forme pllakore
Ngushtimet gjenetike, ndarja ne blloqe e trupave xeherore per shkake te tektonikes shkeputese, ngritja dhe ulja e structures per aresye gjenetike dhe shkalla e ndrysheme e erozionit ka bere qe te mos kemi gjithemone dalje siperfaqesore.
Tektonika e pasemineralizimit eshte shume e zhvilluar me amplitude nga 0.5m-50 m,Blloqet e ndare nga tektonika e pasemineralizimit ndryshojne nnga 2-5m deri ne40-60m.Tektonika ka vepruar ne planin e shtrirjes dhe te renies duke shkaketuar ne shumicen e rasteve hapjen e kraheve.
Kontakti i mineralit me shkembejte rrethues eshte i qarte,rralle here gradual.
Njihen trupat xeherore Veriori i I, II, III,Jugori i I, II.
Me punime minerare jane shfrytezuar tre trupat e pare.

- Antiklinali dhe zhytja duken qarte ne projeksionin horizontal.
- Ne pjesen perendimore trashesia eshte 1-4m dhe shtrirja 40-45m.
- Ne pjesen lindore trupi ka forme tubolare me gjetesi 20m dhetrashesi 8-10m.Permbajtja e mineralit eshte 44-48%Cr_2O_3,e qendruesheme ne te gjithe pjeset e trupit.Ne lindje trupi eshte nderprere me tektonike ne profilin XLI dhe duhet kerkuar pas tektonikes.Kuota me e larte e trupit eshte +1500m dhe eshte kapur me punime shpimi deri ne horizontin +1070m.Mendohet se vazhdon deri ne horizontin +900m.Ne perendim ky trupe eshte nderprere nga tektonika ne profilin XIII galeria 24 dhe eshte takuaar perseri ne galerine 27 profilin XIX XX me nje cvendosje rrethe 120m.Krahu perendimor me rezultatet e njohura nga shpimet vazhdon poshte galerise 28 +1100m.

- Trupi jugori i pare shtrihet ndermjet profilit I--XV,brenda kondicioneve mes profileve III-IX.Ka natyre pllakore me gjatesi ne shtrireje 120m dhe ne renie 320mTrashesia varion nga 0.5-4m. Me permbajtje te qendruesheme 48-50%Cr_2O_3.Niveli me i fundit i ketije trupi eshte horizonti +1295m galeria 26 ne profilin XI.
- Trupi veriore i trete dhe jugore i dyte kane permbajtje te ulet dhe nuk jane shfrytezuar.Qendrueshemeria e shkembejeve rrethues dhe mineralit eshte e larte deri mesatare.Mbi 90% e punimeve jane pa armatim.Pesha volumore luhatet vnga 2.9-3.94gram/m3.Ne drejtim te zhytjes te krahut lindore pas prerjesLI shfaqet trupi shoqerues i kromit II qe fillon ne kuoten e galerise 27 dhe vazhdon ne thellesi deri ne horizontin +1040m, profili LXI.

Ndertimi gjeologjik i venburimit

Ne ndertimin gjeologjik te venburimit te Theknes marrin pjese keta shkembinje:
Dunite, dunite pak te serpentinizuara, dunite te serpentenizuara, dunite piroksenike,harcburgite , harcburgite pak te serpentinizuara, seria damarore, trupi mineral dhe deluvionet.

Kane perhapje te kufizuar, takohen ne forme thjerrzash me shtrirjen 30 - 80 m deri ne 120 m, trashesi deri ne 7 - 50 m. Zhvillohen me shtrirje te pergjithshme Veriperendim - Juglindje me azimuth mesatare 3200. Ata kane nje shperdarje jouniforme dhe takohen ne mes te harcburgiteve, me shkalle te ndryshme serpentinizimime kalime graduale midis tyre. *Dunitet* jane shkembijenj monominerale me ngjyre jeshile ulliri ose dhe me tecelet, me structure kokrrizore te vogel dhe teksture massive. Ne ta takohen pikezime te kromshpineliteve te shperdara jouniformisht.

Dunitet pak te serpentinizura kan perhapje te kufizuar dhe takohen ne mes te harcburgiteve me te njejten shkalle serpentinizimi me kalime graduale midis tyre. Keta thjerrza dunitike ruajne ne pergjithesi ne shtreirje elemente te njejte me ata te rajonit. Ata jan shkembinj te forte me structure kokerrvogel, teksture massive dhe me ngjyre te gjelbert deri ne te gjelbert hiri. Olivina paraqitet e serpentinizuar me forme te crregullt te kristaleve.

Ne keta dunite dallohen pikezime te imta te kromshpinelitit aksesore. Ne siperfaqe ata paraqiten te altrnuar me trashesi 1 - 2 cm.

Dunitet e serpentinizuara dallohen nga te mesipermetper nga siperfaqeja me e vogel qe zene. Ata jane te alternuara. Kristalet e olivines jane te pershkruara nga rrjete damaresh krizotili dhe antigoriti, te cilat pjeserisht jan te mbushura me grimca manjetiti dytesore.

Ngjyra e tyre eshte e gjelber, e gjelber e mbyllur gje qe u jep shkembinjeve nuance te zeza.

Ne disa raste dunitet e serpentinizura pershkohen nga rrjete serpentine e tipit serpofit. Ne keta lloje dunitesh sasia e kristaleve te kromshpinelitit aksesor ndryshon nga dunite me pikezime te rralla. Ne dunitet me sasira te medha kromshpinelitesh qe jan te vendosura jo uniformisht ne masen e shkembit arrin ne 0.1 - 1.3 %.

Dunitet piroksenike jane lloje dunitike te tilla ne te cilat verehen 1-3-5% kristale te piroksenit. Ata jane takuar ne sasira te vogla dhe me shkalle te njejte serpentinizimime shkembinjte qe kontaktojne. Serpentina eshte rrjetore e tipit krizotil. Ne masen masen e duniteve piroksenitike dallohen kromshpinelite aksesore ne forme pikezimesh te imta dhe te rralla, te shperdara ne menyre jouniforme.

Harcburgitet zene siperfaqe te medha dhe kane shkalle te ndryshme serpentinizimi. Kontakti I tyre me dunitet eshte I qarte, gradual, tektonik dhe I mbuluar. Harcburgitet jane me ngjyre te gjelbert, te gjelber te mbyllur dhe te celet dhe me fortesi 4 - 5. Nga ana tektonike jane te shkaterruara dhe te copetuara ne drejtime te ndryshme.
Harcburgitet pak te serpentinizuara kan perhapje me te madhe se ata me te siperme dhe ndodhen ne te njejtin vend. Jane pak te alternuara dhe kane fortesi met madhe. Permbajtja e kristaleve te piroksenit luhatet nga 20 - 25 % me nje shperdarje jouniforme te tyre. Ata kan teksture masive dhe structure kokrrizore te mesme. Kristalet e piroksenit jane me madhesi te nryshme 2 - 6 mm dhe ne disa raste takohen fenokristale te tyre. Ne mase shkembore takohen pikezime te holla dhe te imta , te rralla te kromshpinelitit aksesore te shperdare jouniformisht. Kontakti I shkembinjeve pak te serpentinizuar eshte gradual. Keta jan te ndotur me hidrokside hekuri.
Harcburgitet e serpentinizuara zene pjesen me te madhe te rajonit. Ne perberjen e tyre marrin pjese keto minerale: Olivina, Pirokseni, Kromshpineliti, Serpentina dhe rralle talku dhe kloriti. Ne siperfaqe jane te alternuar 1 - 3 cm.
Kane ngjyre te gjelbert me nuance te kuqerrmtederi ne kafe te verdhe. Ne thyrje kan ngjyre te gjelbert ne te erret. Sasia e kristaleve te piroksenit me madhesi 2 - 3 mm arrin ne mase 15 - 20 %. Ata formojne ne disa raste teksture brezore, por shpesh jan te shperdara ne menyre jouniforme. Shkalla e serpentinizimit te tyre eshte e ndryshme, eshte zhvilluar tektonika shkeputese si ne shtrirje dhe ne renje. Ata kan struktur poikilitike. Serpentina paraqitet me structure rrjetore dhe te ngopur me hidrokside hekuri. Shtrirja e pergjithme e tyre eshte 300 - 3300. Ne masen e shkembit jan shperdare ne menyre jouniforme pikezime te rralla dhe te imta kromshpineliti aksesore.
Serpentinitet taakohen gjate prishjeve tektonike dhe ne kontakt me trupin mineral. Sipas mineraleve relike te mbetura nga shkembijte meme dallojme dunite , serpentinite dhe harcburgite. Masa e serpentiniteve eshte pershkruar nga damare te shumte krizotili me drejtime te ndryshme. Ata permbajne pikezime te shumta te kromshpineliteve aksesore si dhe magnetit dytesore te orientuar ne te njejtin drejtim duke idhene shkembit nje teksture mikrokokrrizore.
Seria damarore perfaqesohet nga damare pirokseniti te serpentinizuar me gjatesi 1 - 1.5 cm. Coperat e shkembinjeve qe takohen jane te serpentinizura dhe te alteruara si dhe te ndotura me hidrokside hekuri. Trashesia e tyre luhatet 0.5 - 2 m dhe ne disa rste kontkti I tyre me shkembijte rrenjesore nuk eshte I qarte.

Pershkrimi i trupit xeheror

Zona per te cilen eshte kerkuar leja e shfrytezimit ndodhet ne pjesen qenrore - lindore te vendburimit Theken dhe eshte pjese e trupit xeherore Jugori i Pare.
Ky trup ne kete pjese te V.B eshte prezantuar dhe shfrytezuar me disa galeri paralele.
Trupi xeheror Jugori i Pare ne kete vendburim ka nje trashesi 0.8 - 2.4 m me nje trashesi mesatare 1.6 m dhe permbajtje te Cr_2O_3 ne kufijte 38 - 45 %. Morfologjikishte ai eshte pllakore dhe ne drejtim te lindjes, zhvillimi ne renje vjen duke u zvogeluar.
Nga dokumentimi i punimeve shtresore rezulton se trupi ka nje renje te forte jugore me kende qe luhaten - dhe nje shtrirje veriperendimore 2900 - 3000.

Tektonika e venburimit eshte mjafte e zhvilluar dhe dallohet si ajo e tipit gjatesore dhe ajo e tipit terthore. Me karekteristike eshte ajo e tipit terthore e cila takohet afersisht ne cdo 6 - 7.

Sistemi i shfrytezimit qe do te aplikohet

Sistemi i shfrytezimit i perdorur eshte ai me galeri nenkati i favorizuar nga pjerresia e trupit dhe treguesit gjeologjik te shkembinjve rrethues dhe mineralit.
Lartesia e katit dhe nenkatit ka qene e kushtezuar nga disniveli i punimeve te hapura me pare,pasi nga ana e subjektit jane ringritur dhe riparuar. Per rrezimin e mineralil ne frontet e shlrytezimit do te perdoren bira me thellesi 2-2.5 m. Ata do te behen me çekiç shpues te zakonshem. te vendosur ne mbajtese pneumatike. Dispozicioni i tyre do te jete ne forme freskorje dhe do te vendosen ne dyshemene e trupit kromitik, afer kontaktit krom gur. Per shpimin e birave, si ne procesin e avancimit te punimeve minerare dhe ate te shfrytezimit do te perdoren çekiçe shpues pneumatike me kollone mbajtese. Meqenese volumi i punimeve qe parashikohet se do te kryhet eshte i vogel. dhe ne vitet e para do te punohet vetem me nje front, gjykohet se procesi i shpimit realizohet me nje çekiç. Gjthsesi per te shmangur difektet qe mund te ndodhin duhet mbajtur edhe nje çekic rezerve ne gjendje pune. Sipas kushteve gjeologjike. minerare dhe te organizimit te punes, ne miniere parashikohet te punohet vetem ne nje deri ne dy fronte, qofte ky ne avancimin e punimeve apo ne procesin e shfrytezimi, pra do te jete ne pune njeheresh vetem nje çekiç shpues, i cili konsumon 3.5 -3.5m3/minut ajer te komprimuar. Bazuar ne sa me siper, nevojat per ajer te ngjeshur do te jene sebashku me humbjet 4m3/min. Lidhja e e kompresorit me pajisjet e shpimit neper frontet e punes do te behet me tubo ajri me diameter = 1.5 polçe gome qe minimizojne humbjet, ose Ø 40 mm, te cilat durojne presion deri 10 bar.

Parametrat kryesore te punimit (oxhakut)

- Seksioni i punimit	2.25 m^2
- Numri i birave	5
- Thellesia e birave	1-1.2 ml
- Koeficenti i shfrytezimit te bires	0.83
- Hapi i avancimit	0.83 ml
- Konsumi specifik	1.4 kg/m^3
- Lloji i lendes plasese	dinamit
- Lloji i kapsollave	Te zakonshem
- Koeficenti i shkriferimit	1.5
- Volumi i materialit te rrezuar	3.4 m^3
- Numri i vagonave 0.33 m^3	11
- Numri i kapsollave	8
- Metrazhi i fitilit	10 ml
- Seksioni ne drite	1.5 m^2

SISTEM SHFRYTEZIMI ME GALERI NENKATI
(Pa horizont ricoptimi)
Shkalla 1 : 500



PRERJA A - A



PRERJA B - B



Parametrat kryesore te punimit (galeri nenkati)

Galeria e nenkatit eshte hapur neper trup me keto parametra kryesore:

- Seksioni i punimit ne avancim	4.2 m^2
- Fortesia e shkembit	7
- Numri i birave ne balle	8
- Thellesia e birave	1 m
- Koeficenti i shfrytezimit te bires	0.92
- Hapi i avancimit	0.92 ml
- Lloji i lendes plasese	dinamit
- Lloji i kapsollave	Te zakonshem
- Konsumi specifik i L.P	1.2 kg/m^3
- Konsumi per nje plasje i L.P	3.8 kg
- Koeficenti i shkriferimit	1.5
- Volumi i materialit te rrezuar	4.5 m^3
- Numri i vagonave 0.33 m^3	13
- Numri i kapsollave	8 cope
- Metrazhi i fitilit	16 ml

Rrezimi i mineralit me bira marteli

Parametrat e rrezimit jane:

- Thellesia e birave	2.5 m
- Diametri i bires	36 – 42 mm
- Thellesia e mbushjes	1.25 m
- Thellesia e Taposjes	1.25 m
- Sasia e lendes plasese ne nje bire	1.2 kg
- Sasia e mineralit te rrezuar nga nje bire	4.8 ton
- Konsumi specifik i L.P	0.25 kg/ton
- Kendi i pjerresise se birave	70 – 75°

Ngarkimi i mineralit me lopate e llamarine te shtruar ne frontin e ngarkimit.
Transporti nga nje cift vagonistesh per ne stoqet e depozitimit ne siperfaqe.

Procesi i ngarkimit ne front

Ngarkimi i mineralit dhe sterilit do te jete i pamekanizuar. Ai do te behet me lopata dore me krahe, ashtu siç veprohet aktualisht ne te gjitha objektet minerare te kromit me te tilla kapacite. Transporti n/tokesor per ne sheshet siperfaqesore te depozitimit si i mineralit dhe i sterileve do te behet me vagona me kosh te kthyeshem.

Sterili do te depozitohet ne sheshet e caktuara, brenda territorit te lejes. Minerali do te depozitohet ne sheshin e depozitimit, qe do te ndertohet ne hyrje te galerise se re 40. Aty do te behet edhe e homogjenizimi i tij dhe prej atje, do te ngarkohet me fadrome me kapacitet kove 1.5 m3 te blere nga shoqeria apo te marre me qera nga te trete, neper automjete per t'u transpotuar deri ne destinacionin e shitjes, po me te trete. Seleksionimi do te behet me dore ne sheshin e depozitimit te mineralit dhe gjate procesit te ngarkimit.

Menyrat e armatimit
Armatimi aty ku munde te perdoret do te jete kryesisht druri ne pjese te veçanta
Fornelet do te jene me dy ndarje te veshur me drrase nga ana e depozitimit te materialit, e me shkalle ne anen e kalimit te punonjesve.Per armatimin e tyre do te perdoret armature druri me kuadro te puthitura.

Transporti i brendshem.
Transporti i mineralit dhe sterilit do te behet ne front per gravitet pasi pjerresia e trupit xeheror e lejon nje variant te tille. Nga fronti deri ne dalje te galerise minerali do te transportohet me vagona 0.86m3.

Furnizimi me ajer te ngjeshur
Sipas organizimit te punes, ne minier parashikohet te punohet ne fronte shembjeje, pra do jene ne pune vetem dy cekic shpues me nga 3.5m^3 ajer ne minute. Per sa me siper nevojat per ajer te ngjeshur do te jene per 7-8 m^3/minute. Per furnizimin me ajer te ngjeshur te pajisjes se shpimit do te duhet nje motokompresor me prodhimtari 10 m^3 minute, i cili do te vendos tek hyrja e galerise 1360/1. Per lidhjen e kompresorit me paisjet e shpimit do te nevojiten edhe rreth 300 ml tuba ajri me Ø 2 polce.Ne punimet e hapjes trupi 7 kalimash 1skema e furnizimit me ajer te ngjeshur do te zgjidhet nga shoqeria dhe munde te perqendrohet ne nje salle kompresori ose munde te jete ivecante per cdo punim.

Trajtimi i pluhurit ne minere. Masat per eleminimin e tij.
Ne kryerjen e punimeve pergatitore te shfrytezimit, shpimi i birave do te behet me cekic shpues pneumatik i cili gjate punes krijon p[luhura qe jane te demshme per shendetin e punonjesit. Per te eleminuar pluhurat qe clirohen nga ky proces do te vendoset shpimi i lagur i cili eleminon pluhurat gjate shpimit te birave. Kjo realizohet me ane te nje bombule e cila ka hyrjen e ajrit te komprimuar dhe daljen e ujit per tek cekici shpues. Kjo metode e shpimit te lagur ehste aplikuar ne minieren e Bulquizes dhe ka dhene rezultate. Ne frontet ku nuk eshte e mundur vendosja e shpimit te lagur, pluhurat do te largohen nga fronti duke intensifikuar ajrimin e tij.
Per largimin e pluhurave gjate procesit te ngarkimit do te aplikohet sperkatja e frontit me uje.

Heqja e ujrave.
Ujrat nentoksore qe burojne nga galerite jane ujra te çarjeve dhe si rrjedhim kane nje shperndarje jo te njetrajteshme.
Prurjet e ujit , qe ushqehen nga ujrat siperfaqesore , jane ne varesi te thellesise se punimeve e te tektonikes dhe jane me te medha ne kohe me reshje dhe gjate shkrirjes se debores. Prishjet dhe zonat tektonike ne disa raste sherbejne si ujembledhes per drenimin e ujrave te çarjeve te zones per rreth tyre.
Prurjet e çarjeve te veçanta lidhen me njera tjetren me zhvillimin e punimeve te shfrytezimit.
Shkembinjte ultrabazike te masivit te Bulqizes pershkohen nga nje rrjet i dendur çarjesh , prishjesh dhe zonash tektonike.
Ujrat e ultrabazikeve ne pergjithesi jane ujra te embla , pa ngjyre , pa ere dhe pa shije , te tipit hidrokarbonat magneziumi , me mineralizim te pergjithshem 0.30-0.40 gr/lit , me fortesi te pergjithshme te ujit 9.5-11 grade gjermane , PH = 8.2 e me shume.

Objekti ne te cilin do te zhvillohen punimet e shfrytezimit, nuk ka sasi te medha uji. Ato do te largohen nga frontet e shfrytezimit dhe punimeve minerare nepermes kanalive anesor te galerise. Prandaj nuk parashikohen ne projekt ujembledhes dhe stacione pompimi.

Shpimi i lagur,
Punimet e shpimit do te kryhen me cekic shpues me goditje e rrotullim me peshe relativisht te lehte qe shpojne ne tjellesi deri ne 4 ml me diameter 38 deri ne 42 mm.
Per te eleminuar pluhurin qe krijohet gjate punes i rekomandohet shoqerise vendosja e shpimit te lagur i cili i eleminon ata. Ky do te realizohet me vendosjen e bombulave te pergatitura qe me pare, te cilat jane te pajisura me dalje ajri dhe uji me saracineska ½ polic. Ajri i komprimuar futet ne bombul, i cili detyron ujin te dale nga bombula per tek cekici shpues. Bombula do te vendoset ne ane te galerise, ne nje vend te zgjeruar qe te mos ngushtoje seksionin e punimit dhe ne anen e tubacioneve te ajrit, te komprimohet. Tubacionet e ajrit dhe te ujit do te jene ½ polic.
Fuqia punetore dhe specialistet do te sigurohet nga zona e Bulqizes mbasi ato jane me pervoje ne profesionet qe trajtuam me siper.

Vendi te depozitimit te mineralit dhe sterilit.
Vendi i zgjedhur per vendosjen e stivave ploteson keto kerkesa :
Gjatesia e rruges nga galerite deri ne sheshin e depozitimit eshte zgjedhur sa me e shkurter.
Vendi i zgjedhur siguron pjerresine ne zbritje dhe nuk bllokon rezervat e mineralit. Ne rastin konkret sheshet e depozitimit do te behen ne shpate mali te cilet pas hapjes se rruges te transportit jane te gatshem per depozitim
Llogaritja e kapacitetit depozitues eshte bere per nje sasi jo te madhe rezervash per faktin se prodhimi parashikohet qe te transportohet direkt nga fronti i prodhimit per ne destinacion.
Shesh i idepozitimit te mbuleses eshte parashikuar, ne projektin e shfrytezimit.
Siperfaqja e sheshit qe do te mbulohet gjate stivimit te shkembit llogaritet me formulen e meposhteme :
Ssh = Vsh x Ksh / h x Ko
V sh – Volumi I shkembit qe parashikohet te depozitohet ne m3
Ksh – Koeficienti I shkriferimit pas ngjeshjes ne stive i cili pranohet 1.1 – 1.2
h – laretesia e stives ne m
Ko – koeficient qe merr parasysh pjerresin e shpatit = 0.09

ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

Sic u trajtua me lart ne kete objekt nuk do te ndertohen objekte siperfaqsore e per rrjedhoje nuk lind nevoja per perdorimin e materialeve te ndertimit.
Lenda e pare e vetme qe do te prodhohet eshte minerali i kromit dhe shkembenjve rrethues qe dalin gjate procesit te shfrytezimit. Per prodhimin e lendes se pare nuk do te perdoren materiale ndertimi, ndersa uji dhe energjia elektrike jane zgjidhur nga shoqeria gjate vitetve te zhvillimit te aktivitetit ne kete objekt. Per prodhimin e lendes se pare do te perdoren keto materiale ndihmese :

Materialet ndihmese	Njesia	Norma
Dinamit	kg/ton	0,25
Kapsolla	Cope/ton	0,8

Ne procesin e prodhimit nuk perdoret perzierje materialesh,
Nuk perdoren kimikate sintetike apo laboratorike

f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;

Ne zonen e projektuar per shfrytezim prej vitesh zhvillohen aktivitete shfrytezimi te mineralit te kromit nga subjekte te ndryshme private. Jane te gjitha mundesite e lidhjes se ketij projekti me rruget, linjat e energjise elektrike etj.. me ato ekzistuese ne periferi te kesaj zone.

g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Procesi i perzgjedhjes se projektit, si dhe alternativat gjate hartimit te projektit/veprimtarise i jane nenshtruar Lejes Minerare nr. 507/1 dt. 04.08.1999 leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe energjise qe shoqeria disponon, ne te cilen eshte percaktuar siperfaqja dhe kordinatat e vendndodhjes se projektit.
Teknika dhe teknologjia e zhvillimit te punimeve te shfrytezimit mer parasysh parandalimin e rreziqeve , mjedisore. Ne rastin konkret shfrytezimi do te behet me nentoke, gje qe minimizon shkarkimet ne ajer te pluhurave, zhurmave dhe gazrave, duke I bere ato te paperfillshme.
Ne projekt parshikohen zgjidhje teknike te punes ne raport me punonjesit qe do te punojne ne objekt dhe kalimtareve te zones. Me rritjen e numrit te punonjesve, shtimit te paisjeve teknologjike ndikimet ne mjedis do te trajtoheshin ne pershtatje me keto ndryshime.
Ne kete projekt jane kryer paraprakisht llogaritja e shpenzimeve qe kryhen per nxjerrjen e 1 ton mineralit te kromit me shfrytezim nentokesor.
Kjo menyre shfrytezimi realizon mekanizimin e plote te proceseve te zbulimit dhe prodhimit te mineralit duke perdorur mekanizma bashkohore me efektivitet te larte ekonomik ne proceset e rrezimit te mineralit, ngarkimit dhe transportit te tij; Realizon siguri te larte ne pune dhe kushte shume te mira pune, rendiment te larte dhe kosto te ulet ne nxjerrjen e mineralit.
Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane marr ne konsiderate :

- *Konditat tekniko - minerare te vendburimit,*
- *Menyra e ngarkimit, transportit dhe depozitimit*
- *Menyra e ngarkimit dhe transportit te mineralit ne brendesi te minieres dhe jashte saj*
- *Mjetet e ngarkimit qe parashikohen te perdoren*
- *Menyra e rrezimit te mineralit*

gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Gjate funksionimit te ketij projekti nuk do te perdoret uji teknologjik dhe ne se do te lind nevoja, jane te siguruara nga investimet e kryera nga shoqeria gjate viteve te zhvillimit te ketij aktiviteti.

h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

Gjate zbatimit te projektit nuk do te linde nevoja per ndërtim te kampeve apo rezidencave te reja. Eshte vendosur nje kontenier me funksionin e zyrave, magazine etj.. .

i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;

Sqarojme qe shoqeria eshte e rregjistrua ne Q.K.R si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Gjithashtu zhvillon prej vitesh aktivitet shfrytezimi ne kete objekt, eshte i pajisur me leje minerare shfrytezimi nr. 507/1 dt. 04.08.1999, leje per perdorimin civil te lendeve plasese dhe leje mjedisore.
Lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi do te jene :

- Leje Minerare Shfrytezimi nr. 507/1 dt. 04.08.1999 objekti "Galeria nr.9 dhe 17" Theken-Martanesh
- Certifikate Ekspert Mjedisor nr.123 prot. dt.09.06.2005 Vendim nr.5, nr.144 Regj.
- License nga Q.K.B. per sherbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis, nr. license LN-4030-11-2017

j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Shoqeria disponon keto leje per zhvillimin e ketij aktiviteti :

- Leje Minerare Shfrytezimi nr. 507/1 dt. 04.08.1999 objekti "Galeria nr.9 dhe 17" Theken-Martanesh
- Urdher Ministri nr. 2494/3 prot. dt.01.07.2025 "njoftim per fillim procedure per zgjerimin e lejes nr.507/1, dt.04.08.1999"

PERGATITI

"D.E.A. PROJEKT" SH.P.K.

licensuar nga Q.K.B. per sherbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis.

nr. license LN-4030-11-2017

Ekspert mjedisor Gezim DAUTI

MINING AND ENVIRONMENT CONSULTING D.E.A. PROJEKT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: **LN-4030-11-2017**
NUIS/NIPT: **L72115007S**

LICENCË

Subjekti: D.E.A. PROJEKT

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative nr.7, Rruga e "Kavajes", zona kadastrale 8250, nr. pasurie 1/992+3-N4

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 02/11/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Specialiteti

Nënshkrimi i sportelit Florinda Fo...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES QKB QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT QENDRËR 11

Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qënë person i tatueshëm.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 123 Prot.

Tirane, me 09.06. 2005

Vendimi Nr.5, Nr.144 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Gëzim DAUTI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem R[redacted]

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E MJEDISIT TIRANE